



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, rada i
transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE/ CENTRAL PROCUREMENT AGENCY**

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIM ME UJË TË PIJES

NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-25-3132-1-1-1

NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-25-3132-1-1-1/C682

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS:

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT, Ndërtesa e ish-Gërmisë Kati IV zyra A 403, Prishtinë (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

ADEA GROUP - SH.P.K., Rr. Mehmet Akif Erosy 3/1, 60000, Gjilan, Kosovë, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Furnizim me ujë të pijes me numër identifikues: UA/2016-25-3132-1-1-1/C682.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Ujë të pijes të ambalazhuar në ambalazhe të ndryshme.

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të paraqitura në Aneksin 7, Autoritetet Kontraktuese mund të shtohen gjatë implementimit të kontratës.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontratë publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe lejohet devijimi prej +/-30%. Autoritetet Kontraktues të përmendura në Aneksin 7 janë të detyruar të përdorin këtë kontratë kornizë sa herë që prokurojnë mallëra të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën 15.08.2025 dhe përfundon në datën 14.08.2028.

1.5 Pavarësisht paragrafit 1.4 kontrata mund të hyjë në fuqi para datës 15.08.2025 nëse kontrata aktuale me nr. do të arrijë pragun e shfrytëzimit prej 130% para kësaj date. Hyrja në fuqi para datës së cekur në paragrafin 1.4 do të bëhet me një njoftim nga AQP drejtuar kontraktuesit dhe AK-ve që shfrytëzojnë këtë kontratë 5 ditë para hyrjes në fuqi.

1.6 Në rast se kontrata do të hyjë në fuqi sipas paragrafit 1.5 atëherë data e përfundimit të kontratës nuk do të jetë data 14.08.2025 por do të jetë 36 muaj nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë maksimum 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes apo porosisë nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë pikat e cekura në porosi të Autoritetet Kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë dhe dorëzimi do të kryhet sipas kushteve të përcaktuara në Aneksin 1.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është 884,670.00 Euro. Devijimi i lejuar është 30%.

4.2 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.3 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Aneksi 1 Specifikimet Teknike;
- (e) Tenderi i Furnizuesit
- (f) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Emine Masurica	Emri:	Behxhet Rruqiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13.06.2025	Data:	13.06.2025
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Alban Shala
Pozita:	Prokur
Nënshkrimi:	
Data:	13.06.2025
Vula:	



PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të

kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruara plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet të bëhen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhrë administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet

kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të prانه për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'i japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpallin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimi derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimi të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimi, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhrë, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është

përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;

d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguheshin ose të cilat do të bëhen obligim për t'u paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimi, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimi të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimi të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërës nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimi të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përkatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimi ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimi të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimi përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimi të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkojnë më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkojnë në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose

- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose

- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të

vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë regjistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë

Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasat ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha që do të përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Autoritetet kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë, brenda 5(pese) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës Secili Autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë do të emërojë një përfaqësues si pikë koordinimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Furnizuesit i cili do të jetë në dispozicion çdoherë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin për të marr vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Kërkohet nga Furnizuesi që të marr nënshkrimet nga personeli i autorizuar për pranimin e mallit. Furnizuesi, në baza 6 mujore, do të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasinë e mallit të dorëzuar tek secili Autoritet Kontraktues dhe sasitë e dërguara në total, në 6 mujorin e fundit të kontratës Furnizuesi duhet të raportoj në baza 1 mujore. Një fletë e veçantë (sheet në Excel) duhet të përgatitet për secilin Autoritet Kontraktues. Raporti duhet minimum të paraqes Sasinë nga secili pozicion i dorëzuar. AQP ka të drejt të kërkoj nga kontraktuesi raportime më të shpeshta dhe kjo do të jetë obligim për kontraktuesin. Mos raportimi me kohë pranë AQP-së nga ana e Furnizuesit, i lejon AQP-në që të marrë masa, siç është konfiskimi i garancionit të ekzekutimit dhe lëshuarja e Referencës negative për kontratën e nënshkruar. Është përgjegjësi e furnizuesit që të mos kaloj pragun e devijimit të lejuar prej +30% edhe për pozicione.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.2	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues të identifikuar në Aneksin 7.

Obligimet përgjithshme Furnizuesit	e te	7.4 dhe 7.5	Autoriteti Kontraktues ne nenin 7.4 dhe 7.5 i referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit. Kontraktuesi do të emëroj një përfaqësues, i cili do të veproj si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jete ne dispozicion çdo here që kërkohet dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marre vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Siguria ekzekutimit	e	8.1	Furnizuesi, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek Agjencia Qendrore e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 88,467.00€ me validitet nga data 15.07.2025 deri me datën 15.09.2028.
Periudha ekzekutimit detyrave	e të	12	Kurdo që ndonjëri nga Autoritetet Kontraktuese pale të kësaj kontrate dëshirojnë që të blejnë produkte sipas kësaj kontrate, duhet që të dërgojnë një "Flete Porosi" tek Furnizuesi.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit		13	Autoriteti Kontraktues ne nenin i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë zgjatja e periudhës së ekzekutimit lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Vonesat ekzekutim	ne	14	Autoriteti Kontraktues ne nenin 14.1 dhe 14.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Suspendimi		15	Autoriteti Kontraktues ne nenin 15 i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Cilësia furnizimeve	e	16.1	Produkti duhet të plotësoj standardet e përcaktuara nga institucionet kompetente në Republikën e Kosovës gjatë gjithë kohës së implementimit të kontratës (pra nëse gjatë implementimit të kontratës ndryshojnë/plotësohen kërkesat nga institucionet kompetente përmes ligjit/udhëzimit/vendimit ato bëhen pjesë e kontratës dhe duhet të respektohen nga kontraktuesi).
Cilësia furnizimeve	e	16.2	Autoritetet Kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm. Pasi që të dërgohet malli dhe nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Autoritetit Kontraktues malli do të konsiderohet si i pranuar përkohësisht. Produkti duhet të plotësoj standardet e përcaktuara nga institucionet kompetente në Republikën e Kosovës gjatë gjithë kohës së implementimit të kontratës (pra nëse gjatë implementimit të kontratës ndryshojnë/plotësohen kërkesat nga institucionet kompetente përmes ligjit/udhëzimit/vendimit ato bëhen pjesë e kontratës dhe duhet të respektohen nga kontraktuesi).
Inspektimi dhe testimi	dhe	17.2	Autoritetet Kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë kanë të drejt të testoj produktin nëse është konform standardeve të lejuara në RKS, Përfaqësuesi i institucionit pas pranimi të produktit në praninë e kontraktuesit do ta njoftoj për testimin dhe ta ftoj kontraktuesin që të jetë i pranishëm gjatë dërgimit të produktit për testim. Në rast se rezultati nuk është konform standardeve të lejuara në RKS kontraktuesit do ti ndërpritet kontrata dhe ti konfiskohet sigurimi i ekzekutimit si dhe do të kërkohet kompensimi i kostove të testimit, në rast se rezultati i testimit është konform standardeve të lejuara në RKS kostot e testimit do të barten nga institucioni që ka dërguar produktin për testim.
Pagesat		18	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga secili Autoritet Kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë për sasinë e porositur nga AK përkatës. Faturat mund të dorëzohen në formë fizike ose elektronike. Ofruesi i Shërbimeve duhet të dorëzoj tek secili autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë faturën për porosit e atij autoriteti kontraktues.
Vonesa ne pagesa		18.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 të kushteve të përgjithshme do t'i japin të drejtë kontraktuesit që

		të mos e realizojë kontratën për Autoritetin kontraktues që nuk ka kryer pagesat, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues përkatës dhe AQP-në. Vendimi i kontraktuesit për të ndërprerë kontratën për ndonjë AK sipas këtij neni, ndikon në eliminimin e pragut minimal (-30%) të devijimit të lejuar të kontratës.
Dorëzimi	19.3	Rreziku i humbjes apa dëmtimit të produkteve nga ndonjë shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur produktet të dorëzohet në pronësi të autoritetit kontraktues. Dorëzimi do të bëhet sipas kushteve të kontratës përfshirë edhe Aneksin 1.
Verifikimi i operimeve	20	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Obligimet garancionit	22.1	Furnizuesi garanton që furnizimet janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara dhe standardet e përcaktuara nga institucionet kompetente në Republikën e Kosovës gjatë gjithë kohës së implementimit të kontratës (pra nëse gjatë implementimit të kontratës ndryshojnë/plotësohen kërkesat nga institucionet kompetente përmes ligjit/udhëzimit/vendimit ato bëhen pjesë e kontratës dhe duhet të respektohen nga kontraktuesi).
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	26	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Ndërprerja e Kontratës nga Furnizuesi	27	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues - AQP-së, të zyrtarëve përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të Furnizuesit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Furnizim me ujë				
Nr.	EMRI I ARTIKULLIT	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA indikativ e
1	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral 0.50L (ambalazhi plastike)	copë	4,100,000
2	Ujë mineral (i gazuar)	Ujë mineral i gazuar 0.50L(ambalazhi plastike)	copë	115,000
3	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral me paketimi minimum 1.5L (ambalazhi plastike)	copë	100,000
4	Ujë mineral (i gazuar)	Ujë mineral i gazuar me paketimi minimum 1.5L (ambalazhi plastike)	copë	9,000
5	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral 0.25L (ambalazhi qelqi)	copë	425,000
6	Ujë mineral (i gazuar)	Ujë mineral i gazuar 0.25L (ambalazhi qelqi)	copë	45,000
7	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral me bidon për aparate statike për ftohje 10 L (ambalazhi plastike) me kapak për aparat siç është e sqaruar më poshtë edhe me foto.	copë	250,000

Produkti duhet të plotësoj standardet e përcaktuara nga institucionet kompetente në Republikën e Kosovës gjatë gjithë kohës së implementimit të kontratës (pra nëse gjatë implementimit të kontratës ndryshojnë/plotësohen kërkesat nga institucionet kompetente përmes ligjit/udhëzimit/vendimit ato bëhen pjesë e kontratës dhe duhet të respektohen nga kontraktuesi).

Në secilin rast të liferimit produkti duhet të ketë minimum 3 muaj deri në skadimin e afatit përjashtim bëjnë rastet kur institucioni gjatë porosisë kërkon që afati të jetë më i gjatë - minimum 6 muaj deri në skadim.

Secili institucion ka të drejtë të testoj produktin nëse është konform standardeve të lejuara në RKS, Përfaqësuesi i institucionit pas pranimit të produktit në praninë e kontraktuesit do ta njoftoj për testimin dhe ta ftoj kontraktuesin që të jetë i pranishëm gjatë dërgimit të produktit për testim. Në rast se rezultati nuk është konform standardeve të lejuara në RKS kontraktuesit do të ndërpritet kontrata dhe ti konfiskohet siguri i ekzekutimit si dhe do të kërkohej kompensimi i kostove të testimit, në rast se rezultati i testimit është konform standardeve të lejuara në RKS kostot e testimit do të barten nga institucioni që ka dërguar produktin për testim.

Pozicioni nr.7 duhet të jetë me kapak të pershtateshm për aparat pra nuk do të pranohen bidonët me kapak të thjeshtë dhe ambalazhim të dobët.

Kërkesa është për këtë lloj kapaki



dhe nuk do të pranohet ky lloj:



(këtu nuk ka rendesi ngjyra por vetëm modeli).

Kontraktuesi është i obliguar të bëjë pastrimin e aparateve që janë në pronësi të institucioneve që furnizohen me artikullin nr.7, pastrimi do të bëhet minimum një herë gjatë implementimit të kontratës dhe me shpenzimet e kontraktuesit.

Kontraktuesit i lejohej që nëse e vlerëson të dobishme në marrëveshje me AK të dërgoj aparate të veta deri në përfundim të kontratës. Këto aparate mund të dërgohen vetëm me pajtueshmëri në mes kontraktuesit dhe AK dhe pa pagesë shtesë.

Për liferimin e produkteve institucioni do të caktoj një vend gjatë porosisë. Kontraktuesi është i obliguar të dërgoj produktet deri tek vendi/hapësira i caktuar (institucioni për një porosi mund të caktojë vetëm një vend/hapësirë ndërsa bartja brenda institucionit është përgjegjësi e institucionit ndërsa institucioni ka të drejt të bëjë disa porosi për disa vende në rastet kur institucioni ka hapsira/objekte në vende të ndryshme).

Ankesi 7 LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE/NJESIVE KËRKUESE

1	Administrata Tatimore e Kosovës
2	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
3	Agjencia e Sherbimit te Navigacionit Ajror
4	Agjencia e Statistikave të Kosovës
5	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
6	Agjencia Katastrale e Kosovës
7	Agjencia Kosovare e Privatizimit
8	Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim te Pronës
9	Agjencia Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
10	Agjencia për Informim dhe Privatësi
11	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit te Klasifikuar
12	Agjencia për Menaxhim Emergjent
13	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës
14	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
15	Agjencia Qendrore e Prokurimit
16	Agjencia Shtetërore e Arkivave te Kosovës
17	Akademia e Kosovës Për Siguri Publike
18	Akademia e Shkencave e Arteve të Kosovës
19	Akademia e Drejtësisë
20	Autoriteti i Aviacionit Civil te Kosovës
21	Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës
22	Autoriteti I Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
23	Biblioteka Kombëtare e Kosovës
24	Dogana e Kosoves
25	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
26	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
27	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
28	Inspektorati Policor i Kosoves
29	Inspektorati Qendror i Punës
30	Institucioni i Avokatit te Popullit
31	Instituti i Historisë
32	Instituti i krimeve te kryera gjatë luftës në Kosovë
33	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
34	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës
35	Këshilli Prokurorial i Kosovës
36	Kolegji IBC-M
37	Komisioni i Pavarur i Mediave
38	Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Mine
39	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
40	Komisioni Rregullativ Prokurimit Publik
41	Kuvendi Komunal Drenasi
42	Kuvendi Komunal Istog
43	Kuvendi Komunal Kllokot
44	Kuvendi Komunal Obiliqi
45	Kuvendi Komunal Prishtinë

46	Kuvendi Komunal Ranillug
47	Kuvendi Komunal Viti
48	Kuvendi Komunal Kaçanik
49	Kuvendi Komunal Lipjan
50	Kuvendi Komunal Prizren
51	Kuvendi Komunal Rahovec
52	Kuvendi Komunal Skënderaj
53	Kuvendi i Republikës së Kosovës
54	Kuvendi Komunal Deçan
55	Kuvendi Komunal Ferizaj
56	Kuvendi Komunal Fushë Kosovë
57	Kuvendi Komunal Gjakovë
58	Kuvendi Komunal Gjilan
59	Kuvendi Komunal Graçanic
60	Kuvendi Komunal Hani Elezit
61	Kuvendi Komunal Kamenicë
62	Kuvendi Komunal Kline
63	Kuvendi Komunal Leposaviq
64	Kuvendi Komunal Mamushë
65	Kuvendi Komunal Mitrovicë
66	Kuvendi Komunal Podujevë
67	Kuvendi Komunal Shtërpcës
68	Kuvendi Komunal Shtime
69	Kuvendi Komunal Vushtrri
70	Kuvendi Komunal Novo Berd
71	N.P.L. Kuzhina Qendrore sh.a.
72	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
73	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
74	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
75	Ministria e Drejtësisë
76	Ministria e Ekonomisë
77	Ministria e Financave Punëve dhe Transfereve
78	Ministria e Industrisë ,Ndërmarrëses dhe Tregtisë
79	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
80	Ministria e Mbrojtjes
81	Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor
82	Ministria e Punëve të Brendshme
83	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
84	Ministria e Shëndetësisë
85	Ministria e Zhvillimit Rajonal
86	Ministria për Komunitete dhe Kthim
87	Organi Shqyrtues i Prokurimit
88	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
89	Policia e Kosoves
90	Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionit të Gjakut
91	Qendra e Mjekësisë Urgjente Prishtine
92	Qendra e Shëndetit Mendor Gjakove
93	Qendra e Shëndetit Mendor Mitrovicë

94	Qendra e Shëndetit Mendor Peje
95	Qendra e Studenteve
96	Qendra Klinike Universitarë e Kosovës
97	QIRSKP Shtime
98	QSHMSHIB Ferizaj
99	QSHNSHIB Prizren
100	Shërbimi Korrektues I Kosoves
101	Spitali I Përgjithshëm Isa Grezda Gjakovë
102	Spitali I Përgjithshëm Pejë
103	Spitali I Përgjithshëm Prizren
104	Spitali Rajonal Gjilan
105	Spitali Rajonal Mitrovicë
106	Spitali Rajonal Ferizaj
107	Spitali Sheik Zayed Vushtrri
108	Universiteti "UKSHIN HOTI" Prizren
109	Universiteti i Gjakovës Fehmi Agani
110	Universiteti i Shkencave të Aplikuara
111	UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
112	Universiteti Publik "Kadri Zeka"
113	Universiteti I Prishtinës
114	Zyra e Kryeministrit
115	Zyra e Presidentes
116	Zyra e Rregullatorit per Energji
117	Zyra Kombëtare e Auditimit



Mehmet Akif Ersoy 3, 60000 Gjilan, Kosovë, Tel. +381-280 327 345, Fax. +381-280 326 923, e-mail: info@ujidea.com,
Website: www.deawater.com

Products

1. Mineral Natural Water DEA 1.5lit PET (Sparkling)

Content	1.5 lit
Bottles per case	6
Cases per pallet	84
Bottles per pallet	504



2. Mineral Natural Water DEA 0.5 lit PET (Sparkling)

Content	0.5 lit
Bottles per case	12
Cases per pallet	108
Bottles per pallet	1296



3. Mineral Natural Water DEA 0.25 lit Glass (Sparkling)

Content	0.25 lit
Bottles per case	12
Cases per pallet	120
Bottles per pallet	1680



4. Natural Mineral water DEA 1.5lit PET (Still)

Content	1.5 lit
Bottles per case	6
Cases per pallet	84
Bottles per pallet	504



5. Natural Mineral water DEA 0.5lit PET (Still)

Content	0.5 lit
Bottles per case	12
Cases per pallet	114
Bottles per pallet	1368




6. Natural Mineral Water DEA 0.25lit Glass (Still)

Content	0.25 lit
Bottles per case	12
Cases per pallet	120
Bottles per pallet	1440



7. Natural Mineral Water DEA 10 lit


Content	10 lit
Bottles per case	1
Cases per pallet	50
Bottles per pallet	50



Furnizim me ujë të pijë - Rikunder - UA/2016-28-3132-1-1-1

Nr. i art.	EMRI I ARTIKULLIT	PËRSHKRIMI	NUJESIA	sasia	Gjimi për linjë ME TVSH	QIMI TOTAL ME TVSH	Vendi i origjinës / Emri i prodhuesit
1	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral 0.50l (ambalazhi plastike)	copë	4,100,000	0.11	451,000.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
2	Ujë mineral (i gazuar)	Ujë mineral i gazuar 0.50l (ambalazhi plastike)	copë	115,000	0.14	16,100.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
3	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral me paketimi 1.5L (ambalazhi plastike)	copë	100,000	0.23	23,000.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
4	Ujë mineral (i gazuar)	Ujë mineral i gazuar me paketimi 1.5L (ambalazhi plastike)	copë	9,000	0.23	2,070.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
5	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral 0.25l (ambalazhi qelqi)	copë	425,000	0.25	106,250.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
6	Ujë mineral (i gazuar)	Ujë mineral i gazuar 0.25l (ambalazhi qelqi)	copë	45,000	0.25	11,250.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
7	Ujë natyral (i pagazuar)	Ujë natyral me bidon për aparate statike për ftohje 10 l (ambalazhi plastike) - me kapak siq është sqaruar në Aneksin 1	copë	250,000	1.1	275,000.00	Kosova/Adea Group sh.p.k
TOTALI						884,670	

Identifikimi i operatorit ekonomik (oe)

Emri i OE:	ADEA GROUP SH.P.K
Emri dhe mbiemri i përfaqesuesit të OE:	ALBAN SHALA
Nënshkrimi:	
Data:	02.05.2025
Vula:	

Prokurimi: UA/2016-25-3132-1-1-1

Nr i brendshëm:

Titulli: Furnizim me ujë të pijes - Ritender

1 Furnizim me ujë të pijes - Ritender

Kodi i tenderit: dea06

Data: 07.05.2025

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1-Deklarata nen betim.pdf
2.	2.0-Deklarate per specifikime teknike.pdf
3.	2A-Deklarate nga operatori ekonomik.pdf
4.	3.0-Certifikata e biznesit me informatat.pdf
5.	3A-AdeaGroup_HACCP Standard.pdf
6.	3B-AdeaGroup_ISO-22000.pdf
7.	4.0-Xhiro qarkullimi bankar.pdf
8.	4A-Gjendja e pergjithshme nga ATK.pdf
9.	4B-Vertetimi i ATK-se mbi qarkullimin.pdf
10.	4C-AdeaGroup_Katalogu i produkteve.pdf
11.	4D-Lista e automjeteve me pershkrime.pdf
12.	5.0-Referencat mbi qarkullimin.pdf
13.	5A-Dëshmitë për furnizime.pdf
14.	6-Siguria e tenderit.pdf
15.	7.0-Analizat e ujit.pdf
16.	8-Identifikimi financiar.pdf
17.	7A-Librezat sanitare.pdf
18.	9-Vertetimi nga ATK.pdf
19.	10-Vertetimi nga Gjykata Ekonomike.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Furnizim me ujë të pijes - Ritender	A_Lista e Cmimeve.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

S'KA

AUTORITETI KONTRAKTUES

Agjencia Qendrore e Prokurimit , Ndertesa e Germis, 10000, Prishtinë,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: UA/2016-25-3132-1-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: ADEA GROUP - SH.P.K., Rr. Mehmet Akif Erosy 3/1, 60000, Gjilan, Kosovë

E-mail: info@ujidea.com

Personi kontaktues: Alban Shala

Telefoni: +38348297297

Faxi: ///

Numri fiskal: 811182857

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: UA/2016-25-3132-1-1-1

Titulli i kontratës: Furnizim me ujë të pijes - Ritender

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Furnizim me ujë të pijes - Ritender

3. Çmimi total i tenderit është:

884,670.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NE KOSOVE
CERTIFIKATE E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

811182857

Numri Unik (identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number)

ADEA GROUP - SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

Mehmet Akif Ersoy Nr3/1
Gjilan


Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

21/08/2012

29/03/2019

Data / Date / Datum

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10013851




Nënshkrimi / Signature / Potpis



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **139950**

Për **AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **ADEA GROUP - SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **FURNIZIM ME UJË TË PIJËS-RITENDER**

Nr. prokurimit: UA/2016-25-3132-111 , Nr. brendshëm: /

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **88,467.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **88,467.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1158 ditë kalendarike prej **15.07.2025** deri më **15.09.2028**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 12.06.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

ADEA GROUP – Sh.p.k.
60000 Gjilan, Kosovë
Rr. Mehmet Akif Ersoy nr. 3/1
Tel. +383-280 327 345
Mob. +383-44 176 839, 125 603
E-mail: info@ujidea.com
Website: www.ujidea.com

Nr. prot. 175/25

Dt. 10.07.2025

Për: Agjencin Qendrore të Prokurimit

Nga: Adea Group-Sh.p.k.

NU.I.: 811182857

Me seli në: Gjilan

A U T O R I Z I M

Autorizohet z. **Kushtrim Avdyli**, me vendbanim në Gjilan, punëtor i Kompanisë sonë:
Adea Group Sh.p.k. NUI. 811182857, në pozitën e punës **Nëpunës Administrativ**, që në
këtë rast vepron edhe si **Menaxher i Kontratës**, të marrë **urdhërblertjet** nëpër
Institucionet përkatëse sipas Tenderit të **Agjencisë Qendrore të Prokurimit** me titull:

“Furnizim me ujë të pijes”

Nr. prokurimit UA/2016-25-3132-1-1-1

Numri zyrtar kontaktues për porosi është: **+383 (0) 48 297 297**

E-mail: info@ujidea.com

Ky autorizim ka karakter special dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.

Autorizuesi:

Drejtori,

Saqip SHALA

